**VENDIM**
**Nr. 230, datë 15.11.2021**

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË "ELVA 2001" SHA, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË PALUAJTSHME (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "a", nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; pikës 1.3, të licencës "Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; nenit 11, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/5 prot., datë 11.11.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Elva 2001' sh.a., për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.",

konstatoi se:

- Shoqëria "Elva 2001" sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 16.8.2021, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Elva 2001" sh.a. për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a..

- Në vijim, me vendimin nr. 214, datë 15.10.2021, Bordi i ERE-s, vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë "Elva 2001" sh.a., për transferimin e aseteve (vendosje hipoteke), në favor të Intesa San Paolo Bank sh.a.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e vendimit, shoqëria "Elva 2001" sh.a. të depozitojë në ERE:

a) listën e transferimeve të kryera më herët, nëse ka pasur;

b) informacion përkatës në lidhje me diferencën e konsiderueshme mes principalit të kredive dhe vlerës së aseteve të paluajtshme, mbi të cilat do të vendoset hipoteka.

- Në zbatim të këtij vendimi, shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën e nënshkruar nga administratori, ku deklarohet se nuk ka pasur transferime të tjera të kryera më herët.

-Për sa i përket informacionit të përcaktuar në pikën 2, germa "b", të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 214/2021, shoqëria ka deklaruar se diferenca e vlerës së aseteve sipas pasqyrave financiare për HEC "Mivas" dhe vlerës së principalit të kredive është financim me mjete të kompanisë "Elva 2001" sh.a. Po ashtu, shoqëria shprehet se e ka informuar më herët ERE-n në lidhje me financimin e kësaj diference me fondet e vetë shoqërisë.

-Sa më sipër, konstatohet se shoqëria nuk ka kuptuar qartë kërkesat specifike të germës "b", të pikës të këtij vendimi, pasi në zbatim të kësaj pike nevojitet informacion mbi diferencën ndërmjet principalit të kredive dhe vlerës së aseteve për të cilat po kërkon autorizimin për t'i vendosur si mjete garantuese të këtyre kredive, dhe jo informacion mbi vlerën fillestare të investimit dhe mënyrës së financimit të saj.

- Përveç sa më sipër, nevojitet që subjekti të saktësojë dhe qëndrimin e MIE-s, të mbajtur në shkresën nr. 2771/1 prot., datë 16.6.2021, drejtuar Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në lidhje me nevojën e marrjes ose jo të miratimit të MIE-s mbi këtë transferim.

- Me qëllim orientimin e drejtë të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s dhe saktësimin/qartësimin e sa më sipër, duke përfshirë dhe zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore, në zbatim të nenit 67, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vlerësohet të shtyhet me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrja e Bordit të ERE-s mbi

kërkesën e shoqërisë "Elva 2001" sh.a. për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të Intesa San Paolo Bank sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë "Elva 2001" sh.a., për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të Intesa San Paolo Bank sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**